



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

VENDIM

NR. 42 DATË 29 /12 / 2017

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PËRFUNDIMTAR TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR PËR VITET 2018-2020 TË BASHKISË VAU DEJËS”.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës _____.____.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, 41, pika 1, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, udhëzimit nr.10 datë 28.2.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”, udhëzimit plotësues nr. 10/1 datë 28.2.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Këshilli i Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm vendor për vitet 2018 - 2020, si më poshtë:
 - a. Të miratojë parashikimin e të ardhurave të vitit 2018-2020, sipas tabelës 1; pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b. Të miratojë detajimin e shpenzimeve për vitin 2018, sipas tabelës 2; pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c. Të miratojë parashikimin e të ardhurave të vitit 2019, sipas tabelës 2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - d. Të miratojë detajimin e shpenzimeve për vitin 2020, sipas tabelës 2; pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- II. Të miratojë parashikimin e investimeve në Buxhetin e vitit 2018-2020 sipas tabelës Nr.3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Të miratojë parashikimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe institucioneve në varësi për vitin 2018, 2019 dhe 2020, sipas tabelës Nr.4 pjesë përbërëse e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Zef HILA